

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIT
TË SHOQËRISË TREGTARE
"BARON AIR" SH.P.K**

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe ndërmarrjet tregtare";
- "Statuti" është statuti i shoqërisë

**KAPITULLI I
Themelimi, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1
Data e themelimit, emri dhe krijuesit.**

1.1 Sot, më 05 mars 2025 themeluesi

- Znj. Fiqirete Tozaj, shtetase shqiptare lindur në Shqipëri, më 13.10.1952, me zotësi të plotë juridike, me id, nr. 036947736, dhe numër personal F26013048Q.

Ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

1.2 Shoqëria do të quhet "BARON AIR" sh.p.k (këtu e më poshtë "Shoqëria"), dhe ka vendosur të nënshkruajë Statutin dhe Aktin e Themelimit në bazë të ligjit të ri që rregullon organizimin e shoqërive.

1.3 1.3 Shoqëria do të organizohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

1.4 Kompania ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

**Neni 2
Objekti**

2.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë, por pa u kufizuar në:

Aktivitet në fushën e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar. Agjent përfaqësimi për kompani ajrore ndërkombëtare. Çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e kompanisë është e pakufizuar.

**Neni 4
Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës në adresën: Rruga "Artan Lenja" Kompleksi Kontakt, Godina Ursa nr.2024, Tiranë.

**KAPITULLI II
KAPITALI**

**NENI 5
Kapitali fillestar**

Kapitali fillestar është i barabartë me 100 000 (njëqind mijë) Lekë i përbërë nga 1 (një) kuotë.

5.1 Ortaku themelues Fiqirete Tozaj zotëron 1 kuotë të kapitalit aksionar, ose 100 % të kapitalit të tij për një shumë prej 100 000 (njëqind mijë) Lekë.

5.2 Kapitali aksionar investohet në total nga anëtarët themelues në para ose në natyrë.

Neni 6

Shtimi dhe pakësimi i kapitalit

Kapitali aksionar mund të rritet ose të pakësohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Rritja e kapitalit mund të diskutohet kur kërkohet nga interesi i Shoqërisë duke vendosur kuotat shtesë të ortakëve.

Asambleja nuk duhet të dëmtojë kreditorët apo të krijojë pasiguri për ata që kanë dhënë kredi përpara shpalljes së pakësimit të kapitalit.

Kapitali mund të rritet ose zvogëlohet sipas vendimit të mbledhjes së ortakëve. Kuotat e pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha nominale dhe të pandashme. Kapitali është plotësisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm. Çdo kuotë i përgjigjet e drejta e një vote.

Neni 7

Pronësia mbi kuotat

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose transferohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerje;
- trashëgimia;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 8

Fitimet ose transferimet e kuotave

Pavarësisht se si fitohen apo transferohen kuotat, kërkohet miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e refuzimit të parë.

Transfertat e kapitalit aksionar duhet të vërtetohen me ligj, përndryshe ato nuk janë të vlefshme.

Neni 9

Fondet rezervë

Kompania krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përmbushur nevojat e saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mjetet financiare për të përmbushur detyrimet gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 10

Përdorimi i të ardhurave neto

Fitimi neto që rezulton pas zbritjes së shpenzimeve të kryera për kryerjen e çdo veprimtarie nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga taksat dhe tarifat, nga kuotat që rrisin kredinë e investimit, pagat dhe shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas vendimit të tyre.

Neni 11 Bilanci

Aktivitet e Shoqërisë vlerësohen në pasqyrat e saj financiare në monedhën vendase ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të aksionarëve ose ekspertëve në kohën e themelimit të shoqërisë

Bilanci vjetor do të prezantohet deri më 31 mars të vitit pasardhës.

Forma e bilancit përcaktohet në përputhje me format e bilancit të vendosur në Republikën e Shqipërisë.

KAPITULLI III ORGANIZMAT E SHOQËRISË

Neni 12 Asambleja e Përgjithshme

Organi bazë i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme diskuton për:

- a) përcakton politikat tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet statutores;
- c) emëron dhe shkarkon administratorët;
- ç) emëron dhe shkarkon likuiduesit dhe auditët ligjor;
- d) përcaktimin e shpërblimit për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të performancës;
- ë) rritja dhe zvogëlimi i kapitalit;
- f) ndarja e kuotave dhe anulimi i tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procese të tjera kundër administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të aksionarëve;
- i) çështje të tjera të parashikuara me ligj ose me statut.

Neni 13 Procedurat dhe thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Ajo thirret nga drejtorët ose aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme në mbledhjen e përgjithshme të shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme thirret:

- në mënyrë vjetore ose kur për raportet financiare të ndërmjetme, ekziston rreziku që aktivitet e shoqërisë të mos mbulojnë detyrimet për 3 muajt e ardhshëm.
- kur Shoqëria synon të shesë ose ndryshe të disponojë asete që kanë një vlerë më të madhe se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezultojnë nga pasqyrat financiare më të fundit të certifikuara.
- kur Shoqëria, brenda 2 viteve të para të regjistrimit të saj, propozon blerjen nga aksioneri i aktiveve që kanë një vlerë më të madhe se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, që rrjedhin nga pasqyrat financiare më të fundit të certifikuara.

Asambleja e Përgjithshme thirret me njoftim me shkrim ose me e-mail.

Komunikimi me shkrim ose me e-mail duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë anëtarëve, jo më vonë se 15 ditë para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk thirret si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët pranojnë të marrin vendime, pavarësisht parregullsive.

Neni 14
Kuorumi

Në rastet e vendimeve që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë anëtarët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve.

Në rast se asambleja e përgjithshme duhet të diskutojë për çështje që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse aksionerët që kanë më shumë se gjysmën e votave të përgjithshme, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrim ose në mënyrë elektronike, në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të thirret për shkak të mungesës së kuoromit të sipërcituar, mbledhja rithihet brenda dhe jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 15
Vendimet në shoqëri

Asambleja vendos me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të aksionarëve pjesëmarrës, ndryshimin e statutit, rritjen ose uljen e kapitalit themeltar, shpërndarjen e fitimeve, organizimin ose shpërbërjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë votash të anëtarëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcakton politikat tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe auditorëve ligjorë;
- ç) përcaktimin e shpërbllimit
- d) mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga drejtorët, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të performancës;
- e) përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procese të tjera kundër drejtorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të asambleve;

Çdo ndryshim në statut duhet të dorëzohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në dosjen e kompanisë.

KAPITULLI IV
ADMINISTRIMI

Neni 16
Administratori

Asambleja e përgjithshme emëron një ose deri në tre persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Mandati nuk mund të kalojë 5 vjet, me të drejtë rinovimi.

Përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e administratorit do të përcaktohen në aktin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme.

Emërimi i drejtorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratorët e një shoqërie mëmë nuk mund të emërohen administratorë të një shoqërie filial dhe anasjelltas.

Administrator i "BARON AIR" sh.p.k do të jetë:

Ikena Tozaj, shtetase shqiptar, lindur në Vlorë, më 09/03/1985, me zotësi të plotë për të vepruar, me numër ID 037459817 dhe nr. personal I55309092S.

Administratori ka të drejtë të kryejë çdo veprim, si dhe të përfaqësojë shoqërinë përpara çdo organi administrativ, gjyqësor ose çdo organi tjetër publik ose privat dhe në marrëdhënie me të tretët.

Asambleja e Përgjithshme mund ta revokojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Statutet ose marrëveshjet e tjera nuk mund ta përjashtojnë ose kufizojnë këtë të drejtë

Neni 17**Të drejtat dhe detyrimet e administratorit**

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrim të:

- Kryejnë të gjitha veprimet administrative të aktivitetit tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të miratuara nga asambleja e përgjithshme.
- Përfaqëson shoqërinë;
- Kujdeset për mbajtjen korrekte dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë
- Përgatit dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe ecurinë e aktiviteteve dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i dorëzon këto dokumente për miratim në asamblenë e përgjithshme;
- Krijimi i një sistemi alarmi në kohë për rrethanat që kërcënojnë mbarrëvajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë;
- Regjistrimi dhe dërgimi i të dhënave të detyrueshme në kompani, siç kërkohet nga ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- Raporton në asamblenë e përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për zbatimin e veprimeve të veçanta me rëndësi të veçantë për aktivitetin e shoqërisë;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statut;
- Të thërrasë asamblenë e përgjithshme kur shoqëria, brenda 2 viteve të para të regjistrimit, propozon të blejë nga një aksioner kuota që kanë një vlerë më të madhe se 5 për qind të kapitalit të shoqërisë, që rezultojnë nga pasqyrat financiare të fundit të certifikuara dhe kur ekziston rreziku që asetet e kompanisë të mos mbulojnë detyrimet brenda 3 muajve të ardhshëm.

Neni 18**Shpërblimi i administratorit**

Mund të shtohet shpërblimi mbi pagën për administratorin, i cili mund të jetë një përqindje fitimi ose e ngjashme. Shpërblimi i administratorit përcaktohet me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme. Shpërblimi duhet të jetë adekuat dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të kompanisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë të ulë shpërblimin e administratorit në masën e duhur.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe incidenca vjetore e shpërblimit të administratorit në strukturën e kostos së shoqërisë publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Ata nuk do të kenë kompensim apo paga deri në një vendim të ardhshëm nga asambleja.

Neni 19**Verifikimi Ligjor**

Shoqëria cakton një auditor ligjor për çdo vit financiar kur përballemi me rastet e parashikuara me ligj. Emërimi i tyre bëhet nga Asambleja e Përgjithshme.

Audituesi i brendshëm, administratori, personat e lidhur me ta deri në shkallën e katërt nuk mund të emërohen si auditues ligjor.

Audituesin Ligjor Meri Lika, të studios Art-Auditing, me numër të kartës së identitetit H15302100U e cakton të kryejë procedurat në platformën e-albania dhe në platforma të tjera me qëllim regjistrimin e shoqërisë së re.

KAPITULLI V MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 20 Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës brenda Shoqërisë rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, Statutit dhe legjislacionit shqiptar të punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me kontrata pune individuale ose kolektive ndërmjet Shoqërisë dhe punonjësve.

Neni 21 Përgjegjësia e Punonjësit

Punonjësit dhe menaxherët e lartë janë përgjegjës për çdo dëm që i shkaktojnë Kompanisë për fajin e tyre dhe janë civilisht përgjegjës për të.

KAPITULLI VI SHPËRBËRJA E SHOQËRISË. LIKUIDIMI

Neni 22 Shpërbërja e shoqërisë

Kjo Shoqëri do të shpërndalet:

- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- me vendim gjykate;

Shpërndarja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin e Shoqërive në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit nga Drejtorët.

Neni 23 Riorganizimi i shoqërisë

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Mbledhjes së Aksionarëve, në përputhje me dispozitat e ligjit të parashikuar në pjesën IX të ligjit 9901, datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 24 Bazat ligjore

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë statut, zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kodi civil dhe çdo ligj tjetër specifik i Republikës së Shqipërisë.

KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 25
Dispozitat përfundimtare

Për të gjitha rastet që nuk rregullohen në këtë Statut, zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Si rezultat i interpretimit të Statutit të sipërpërmendur, Ligji Tregtar nënkupton Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Shoqëritë Tregtare".

Çdo pavlefshmëri e dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të ndikojë në vlefshmërinë e tij

Neni 26
Gjykata kompetente

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe për interpretimin e Statutit është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky Statut dhe Akt Themelimi hyjnë në fuqi dhe janë të detyrueshme për ekzekutim nga momenti i nënshkrimit të anëtarëve.

ORTAKU I VETËM THEMELUES I SHOQËRISË
BARON AIR

Figjirete Tozej 